



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 47, Datë 17.02.2026

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “TIRANA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.02.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 66/6 prot., datë 17.02.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 146, datë 24.06.2021, me afat vlefshmërie deri më 24.06.2026.
- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2983/1 prot., datë 24.12.2025, brenda afatit të përcaktuar nga Rregullorja.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 1, datë 08.01.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 09.01.2026 dhe 10.01.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.01.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Gjithashtu njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 66/1 prot., datë 15.01.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 66/2 prot., datë 22.01.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues për aplikimin, nga analizimi i të cilit rezultoi se shoqëria kishte ende dokumentacion që nevojitej të plotësohej. Për rrjedhojë, me e-mailin me nr. 66/3 prot., datë 29.01.2026, ERE i kërkoi shoqërisë depozitimin e këtij dokumentacioni.
- Me qëllim për t'i dhënë mundësi shoqërisë që të depozitojë këtë dokumentacion, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 04.02.2026, vendosi të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për kërkesën e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.
- Së fundi, nëpërmjet e-mailit të protokolluar në ERE me nr. 66/5 prot., datë 04.02.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit.
- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, ka shlyer pagesat e rregullimit dhe gjithashtu ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike,”* miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën me nr. 490, Seria T21, të shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 146, datë 24.06.2021, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 25.06.2026.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît AHMETI